



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

TREGU I FTOIT



Mars, 2016

**DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE DHE
STATISTIKAVE BUJQËSORE**

ANALIZA E TREGUT TË FTOIT

Mars, 2016

Parathënie

Ftoi, fruti mbret i vjeshtës, si kulturë mediteriane ka traditë të gjatë të kultivimit edhe në Kosovë. Për shkak të përshtatshmërisë së kushteve klimatike në Kosovë, me kërkesë mesatare të ujitjes, klimë mesatare kontinentale me dimër të butë, Kosova ka potencial për kultivimin të kësaj kulture. Edhe pse tradicionalisht është kultivuar në sipërfaqe të vogël viteve të fundit vërehet një interesim i shtuar për kultivim të kësaj kulture.

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore një ndër detyrat kryesore ka analizën e prodhimeve bujqësore. Një analizë e tillë është edhe kjo e tregut të ftoit, e cila paraqet një pasqyrë të përgjithshme të situatës dhe trendeve të zhvillimit të tregut të kësaj kulture në Kosovë.

Në këtë analizë shtjellohen të dhënat e prodhimtarisë vendore, eksportit dhe importit, çmimeve të ftoit vendor si dhe atyre të importuar, madhësisë së tregut, mbështetjes, promovimit, sfidat si dhe konkluzionet finale mbi këtë analizë.

1 Tregu i ftoit

Në vitin 2014, sipas të dhënave të Regjistrimit të Bujqësisë në Kosovë ishin 26 ha plantacione të mbjellura me ftonj. Trupa të shpërndarë të kultivuar jashtë plantacioneve, kryesisht në kopshte të ekonomive familjare bujqësore janë 95,335

trupa. Duke marrë parasysh të dhënat e fundit gjatë viteve '08-'14 mund të shohim se në vitin 2014 është shënuar rënie e sipërfaqes së kultivuar me këtë kulturë krahasuar me periudhën paraprake.

2 Prodhimtaria vendore

Në vitin 2014, prodhimtaria e ftoit në Kosovë vlerësohet të ishte rreth 1,108 tonë, ku prodhimtaria nga sipërfaqet e mbjellura në plantacione ishte 224 tonë ndërsa jashtë plantacioneve është vlerësuar se prodhimtaria ishte 884 tonë, kjo duke llogaritur një prodhimtari

mesatare prej rreth 9.3 kg/trup. Për të plotësuar nevojat vendore për konsum, gjatë vitit 2014 Kosova ka importuar 173 tonë ftonj, ndërsa sasia e importuar gjatë vitit 2015 ka shënuar rënie në 137 tonë. Për dallim nga importi, gjatë këtyre dy viteve nuk ka pasur fare eksport.

3 Zhvillimi i tregtisë

Kosova për të përmbushur nevojat vendore për konsum në periudhën '08-'15 ka importuar mesatarisht 135 tonë ftonj dhe gjatë kësaj periudhe kohore, vetëm në vitin 2010 ka pasur eksport të ftonjve me


një sasi prej 0.6 tonë. Gjatë periudhës '08-'15, sasia më e madhe e importi ka qenë në vitin 2013, ku janë importuar 185 tonë ftonj, për të pasuar me rënie në vitin 2014 dhe 2015.

3.1 Importi i ftoit

Në vitin 2015 Kosova ka importuar 137 tonë ftonj krahasuar me vitin 2014 në të cilin janë importuar 174 tonë, ku sasia e importuar në vitin 2015 është 27% më e ulët se në vitin 2014. Vlera e importit të ftoit në vitin 2015 ka arritur në 105,019 €.

Shikuar në aspektin kohor sasi më të madhe të ftoit të importuar kishte në vitin 2013 me 185 tonë ndërsa sasia më e ulët ishte në vitin 2008, me vetëm 99 tonë të importuar.

Figura 1: Importi i ftoit të freskët '08-'15, në metrik tonë




Burimi: MBPZHR- DAESB

Në figurën e mëposhtme është paraqitur vlera e importit për vitet '08-'15. Shikuar në aspektin kohor shihet se vlera e importit ka shënuar rritje të vazhdueshme,

përveç në vitin 2012 ku ka pasur rënie. Në vitin 2008 vlera e importit ka qenë rreth 47 mijë € ndërsa në vitin 2015 kjo vlerë ka arritur shifrën 105 mijë €.

Figura 2: Importi i ftoit të freskët '08-'15, në 1000 €




Burimi: MBPZHR- DAESB

Në vitin 2015 ftoi është importuar kryesisht nga Turqia (75%) dhe Greqia (24%) ndërsa nga vendet e tjera vetëm 1%.

Edhe në vitet e tjera importi i ftoit ka qenë kryesisht nga këto vende: Turqia, Greqia, Shqipëria dhe Maqedonia.

Figura 3: Importi i ftoit sipas vendeve, 2015




Burimi: MBPZHR-DAESB

3.2 Eksporti i ftoit

Nga viti 2008 deri në vitin 2015 eksport të ftonjve ka pasur vetëm në vitin 2010, ku sasia e eksportuar ka qenë 0.6 tonë në

vlerë prej 171 €. Në vitin 2010 ftoi është eksportuar vetëm në Zvicër.

Figura 4: Eksporti i ftoit të freskët 2008-2015, në kg




Burimi: MBPZHR-DAESB

Bilanci tregtar i ftoit

Nga figura e më poshtme shihet se vlera e bilancit tregtar ka qenë më e larta në vitin 2013 prej 184,535 €, ndërsa nëse e shikojmë në aspektin e raportit në mes eksportit dhe

importit në vitin 2010, që është viti i vetëm kur ka pasur eksport, mbulueshmëria ka qenë vetëm 0.24%.

Figura 5: Bilanci tregtar i ftoit, në 1000 €



Burimi: MBPZHR-DAESB

4 Çmimet e tregut

Tregu i ftoit nuk është edhe aq i madh krahasuar me kulturat tjera. Sa i përket kulturës së ftoit në tregun tonë gjendet ftoi vendor edhe ai i importuar. Ftoi vendor gjendet në treg zakonisht gjatë muajve


Shtator, Tetor dhe Nëntor, varësisht nga kushtet klimatike, ndërsa ftoi i importuar gjendet në tregun tonë pothuajse gjatë tërë vitit.

4.1 Çmimet në tregun vendor

Plasimi i ftoit vendor fillon në muajin Shtator dhe vazhdon deri në muajin Nëntor, varësisht nga kushtet klimatike. Sasia më e madhe e prodhimit të ftoit shitet gjatë kësaj periudhe ndërsa një sasi e vogël nga disa fermerë ruhet dhe shitet edhe në pjesën tjetër të vitit. Çmimi mesatar vendor në tregun me pakicë për vitin 2013 ishte 1.26 €/kg, ndërsa në

tregun me shumicë 1.04 €/kg. Gjatë vitit 2014 çmimi mesatar vendor në tregun me pakicë ishte 0.88 €/kg, ndërsa në tregun me shumicë 0.75 €/kg. Gjithashtu, gjatë vitit 2015 nuk ka pasur luhajtje në çmime të tregut vendor, me mesatare të çmimit të tregut me pakicë prej 0.81 €/kg, dhe tregut me shumicë prej 0.75 €/kg.

Figura 6: Çmimet vendore 2013-2015, €/kg




Burimi: MBPZHR-DAESB

4.2 Çmimet e importit

Ftonjt e importuar gjenden në tregun tonë pothuajse gjatë tërë vitit, ku sasi më të madhe të importit ka në periudhën kur nuk është i pranishëm prodhimi vendor. Çmimi mesatar në tregun me pakicë i ftonjve të importuar për vitin 2013 ishte 2.26 €/kg, ndërsa në tregun me shumicë

1.19 €/kg . Gjatë vitit 2014 çmimi mesatar në tregun me pakicë ishte 1.86 €/kg, ndërsa në tregun me shumicë 1.66 €/kg. Gjatë vitit 2015 ka pasur një rënie të çmimeve, ku mesatarja e çmimit në tregun me pakicë ishte 1.35 €/kg, dhe në tregun me shumicë 1.12 €/kg.

Figura 7: Çmimet e importit 2013-2015, €/kg



Burimi: MBPZHR-DAESB

5 Madhësia e tregut

Tregu i përgjithshëm i ftoit në Kosovë gjatë vitit 2014 vlerësohet të ishte rreth 1,282 tonë. Kjo përfshinë gjithë prodhimtarinë vendore si dhe importin ndërsa eksport të ftoit nuk ka pasur gjatë

këtij viti. Tregu vendor vlerësohet se mbulon rreth 86% të nevojave për konsum të ftoit ndërsa pjesa tjetër prej 14% mbulohet nga importi.

6 Mbështetja e prodhimtarisë së ftoit

Prodhimtaria e ftoit në Kosovë në vitin 2016 do të ketë mbështetje financiare/grante për investime në fermë në kuadër të masës 101 "Investimet në Asetet Fizike në Ekonomitë Bujqësore"

sipas planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Në vitin 2015 ftoi është mbështetur edhe përmes pagesave direkte gjë që do të vazhdoj edhe gjatë këtij viti.

6.1 Pagesa direkte për ftoin

Objektivat që tentohet të arrihen përmes pagesave direkte janë: rritja e rendimentit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore dhe zvogëlimi i shpenzimeve të prodhimit e kjo do të ndikoj në rritjen e të hyrave dhe përmirësimin e aftësisë konkurruese.

Për prodhimtarinë e ftoit në Kosovë, aplikuesit për të përfituar nga programi për pagesa direkte si kriter kryesor duhet të kenë së paku 0.50 ha sipërfaqe të mbjellur dhe ti plotësojnë kriteret tjera të parashtruara sipas programit. Ndër kriteret tjera kryesore janë që parcela e mbjellur me pemë në pronësi ose e marr

me qira duhet të jetë minimumi 0.20 ha e pandarë si dhe numri minimal i trupave për hektarë duhet të jetë 750 trupa.

Në vitin 2015 pagesat direkte për pemishte ekzistuese (pemë drufrutore dhe pemë të imta), janë implementuar për herë të parë. Në vitin 2016 ka vazhduar subvencionimi i njejtë sikur në vitin 2015 dhe pjesë e listës së pemëve që do të subvencionohen janë: molla, dardha, kumbulla, ftoi, kajsia, pjeshka, qershia, vishnja, mushmolla, arra, lajthia, aronia dredhëza, boronica, mjedra dhe manaferra. Subvencionimi do të bëhet për sipërfaqë (ha) të mbjellur me ftonj dhe shuma e pagesës do të jetë 400 €/ha.

6.2 Masat e zhvillimit rural që përkrahin sektorin e pemëve – ftoin

Në kuadër të masave të zhvillimit rural në vitin 2016 prodhimitaria e ftoit do të përkrahët në kuadër të masës 101, **“Investimet në asete fizike në ekonomit bujqësore”**.

Objektivat e përgjithshme të kësaj mase janë: rritja e aftësisë konkurruese dhe zvogëlimi i importit, krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale, përkrahja e bujqve në sektorët e përzgjedhur me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e BE-së, përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave dhe adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtëritshme.

Objektivat specifike të kësaj mase janë: rritja e prodhimit të pemëve për qëllime komerciale, përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së, modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizmit modern, zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në infrastrukturë dhe pajisje për fazën pas vjeljes, përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim, prodhimi i energjisë së ripërtëritshme, përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e prodhimeve bujqësore.

Fermeri në momentin e aplikimit duhet të dëshmojë posedimin e sipërfaqes

bujqësore, në pronësi apo të marrë me qira për së paku 10 vjet dhe të ketë të regjistruar në Regjistrin e Fermave sipërfaqen prej së paku 1 hektar për pemë drufrutore. Sipërfaqja minimale e ngastrës për pemë drufrutore duhet të jetë 0.50 hektar.

Përfituesit për ngritjen e pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, së paku duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriteret CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese. Fidanët e mbjellur të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues.

Nëse fermeri aplikon për investime në depo për pemë drufrutore ai duhet të dëshmojë posedimin e sipërfaqes së tokës së punueshme në pronësi apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, dhe të ketë të regjistruar në Regjistrin e Fermës sipërfaqen prej së paku 2 ha.

Vlera minimale e pranueshme për projektet për pemë drufrutore është 10,000 €, ndërsa vlera maksimale është 100,000 €. Përkrahja publike është 60% e

shpenzimeve të pranueshme të investimit, ndërsa përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në ekonomi bujqësore (ferma), të udhëhequra nga fermerët e rinjë (40 vjeç ose më të rinjë) dhe 5% për investime në ekonomitë bujqësore (ferma) në viset malore. Shuma totale e ndarë për përkrahje të pemëve drufrutore në vitin 2016 është 2,500,000 €. Investimet përfshijnë:

- investimet në ngritjen e pemishteve të reja me pemë drufrutore me sipërfaqe 1 ha,
- investimet në vendosjen e sistemin të ujitjes në fermë, sipas praktikave efikase të ujitjes,

7 Promovimi dhe sfidat

Deri më tani nuk ka pasur ndonjë iniciativë të veçantë për promovimin e ftoit. Një ndër arsytet për këtë është se kjo kulturë ka filluar të mbështetet vetëm nga viti i kaluar.

Falë veçorive biologjike të ftoit (lulëzim të vonshëm dhe pjekuri po ashtu të vonshme) dhe kushteve të përshtatshme klimatike në vendin tonë, tregu për këtë kulturë tek ne ka mundësi të zhvillohet me mjaft sukses.

-prodhimi i energjisë në fermë nga burimet e ripërtëritshme,

-investimet në vendosjen e rretave për mbrojtje nga breshëri,

-investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes,

-investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave dhe objekteve për vendosjen e produkteve për mbrojtje të bimëve dhe plehrave artificiale.

Me përkrahjen që po i bënë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sektorit të pemëve përmes subvencioneve dhe granteve, pritet që kjo kulturë të kultivohet edhe më tepër, ku do të kemi zgjerim të sipërfaqeve të mbjellura me ftua që do të përdoret si i freskët ose si lëndë e parë për industrinë përpunuese për lëngje dhe forma të ruajtjes afatgjatë (marmelata, reçel, kompot, djathë i ftoit, ëmbëlsirë nga ftonjt, suxhuk nga ftoi si dhe pije alkoolike dhe jo alkoolike.

Konkluzionet

Nga të gjitha të dhënat e paraqitura në analizën e tregut të ftoit mund të konkludojmë se në Kosovë prodhimtaria e ftoit përmbush kërkesat për konsum në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, për t'u plotësuar nevojat e përgjithshme vendore Kosova vazhdimisht ka importuar ftonj. Me rritjen e mëturjes së sipërfaqes së mbjellur me ftonj, do të rritej prodhimtaria dhe mundësia për eksport të ftoit. Kjo do të ndikonte edhe në uljen e vlerës negative

të bilancit tregtar për këtë kulturë e njëkohësisht edhe në vlerën e përgjithshme të bilancit tregtar. Duke pasuar parasysh mundësitë e shumta për përpunim të ftoit (llojllojshmëri të produkteve) kjo kulturë shihet si mundësi e mirë për zgjerim të kapaciteteve prodhuese të industrisë përpunuese, çka do të ndikonte në krijim të vendeve të reja të punës dhe zhvillim ekonomik të vendit.